



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Struktura: Org. Instancë: Org. Unit: Nr. i Fajetave: Pro. Struktura: Nr. i Fajetave:	ARPL H 5255-2/25 11.07.25 PRISHTINË / A No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	10.07.2025
REFERENC-Ë:	5255/25 - ZSP - 2025 ARPL
PËR/ZA/TO:	„Drejtoria për Urbanizem, Kadastër dhe Gjeodezi, K. Mitrovica Veriore
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Fatos QERIMI, Drejor i ARPL-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim – Pëlqim Ujor

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ka shqyrtuar kërkesën dhe Dokumentacionin e dorzuar, me Nr. të protokollit: 5255/25, parashtruar nga „Drejtoria për Urbanizem, Kadastër dhe Gjeodezi, K. Mitrovica Veriore dhe ka vendosur si në Pëlqimin Ujor, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

PU

Datë: 10.07.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

PËLQIM UJOR

APROVOHET kërkesa e palës, me Nr. Protok. 5255/25, me datë 08.07.2025, nga „Drejtoria për Urbanizem, Kadastër dhe Gjeodezi, K. Mitrovica Veriore, për Pëlqim ujq, lidhur me projektin financues nga MMPHI-ja “Ndërtimi i Urës për këmbësor dhe autormjete mbi Lumin Iber” Ngastra e lumit, me Nr. P-73808130-03546-26, me qëllim të lidhjes së K. Mitrovica Veriore me Mitrovicën Jugore, për këmbësor dhe autormjeteve.

Pëlqimi Ujq jepet me këto kushte :

1. Pëlqimi Ujq lëshohet në baze të dokumentacionit investivo-teknik i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi, dhe si i tillë ruhet nga pala, K. Mitrovica Veriore;
2. Pëlqimi Ujq vlenë vetëm për ndërtimin e pjesëve përbërëse të konstruksionit të urës;
3. Pala për vazhdim të ndërtimit duhet t'i nënshtrohet rregulloreve teknike të zhvillimit të punimeve hidroteknike, duke përfshirë edhe masat mbrojtëse mbi dhe nën rrjedhën e poshtme, të ujërrjedhjes;

4. Nëse gjate fazës së ndërtimit vije gjërë të çrregullimi i regjimit ujqor, gjërë të proceset erroduese në shtrat të lumit nga infrastruktura ujqore, e kjo shkakton dëme te çfarëdo karakteri, pala është e obliguar që shkaqet e dëmit t'i eliminoj, kurse dëmet t'i kompensoj;
5. Të gjitha makineritë ndërtimore, duhet të përdoren në harmoni me normat dhe praktikatat mjedisore të mbrojtjes, nga derivatat e naftës;
6. Pëlqimi ujqor nuk paraqet të drejtën pronësore, ose të drejtën për shfrytëzimin e tokës, respektivisht të objekteve dhe pajisjeve të cilat nuk janë në pronësi të bartësit të pëlqimit ujqorë;
7. Nëse me Plane për menaxhimin e pellgjeve lumore, parashihet diçka tjetër në at vend, pala është e obliguar që objektin ta largoj, si dhe llogaritë financiare bien mbi palën;
8. Vlefshmëria e pëlqimit ujqorë është dy vite, nga data e lëshimit të tijë, nëse deri me kete datë nuk kan filluar punimet.
9. Validiteti i Pëlqimit Ujqor pushon në rast të mos plotësimit të këtyre kushteve të lartë cekura, në afat kohor te validitetit të vendimit.

ARSYETIM

Zyrtarët e ARPL-së, duke u bazuar në "Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujqore", kërkesën për Pëlqim Ujqor nga "Drejtoria për Urbanizem, Kadaster dhe Gjeodezi, K. Mitrovica Veriore, për kalim mbi pronën ujqore, me Nr. Ngas. P-73808130-03546-26. të parashtruar në emër të dy Komunave për Urën e cila do të ndërtohet në lokacionin Rr "Çlirimi " konkretisht do të kaloj nga parkingu publik në K. Veriore, afër urës kryesore të Ibrit dhe do të lidhet me rrugen përgjatë anës lindore të Palestres "Minatori" të Mitrovicës Jugore. Kërkesën e parashtrorj në emer te dy Komunave, bazuar në marrëveshjen e Bordit të përbashkët të të dy Komunave, nga e cila marrëveshje Komuna e Mitrovicës Veriore, është e obliguar t'i plotësoj kushtet për Urën për Automjete dhe këmbësor, në lokacionin e lartëcekur. Kërkesës ia ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim: Autorizimin për zyrtarin përgjegjës z. Fisnik ABRASHI për ndërmarrjen e veprimeve procedurale; Kopje e Planit për ngastren dhe Certifikata e pronësisë së Pasurisë ujqore, Nr. P-73808130-03546-26; Kopje plani dhe Certifika e pronësisë për Ng. P-73808130-024558-0, ne pronësi te K. Mitrovica Veriore; Ortofoto e ngastrave; Metodologjia e llogaritjes së plotave shumëvjeçarenë pikën e kalimit mbi pronën ujqore; Projekti i deor i urës (Baza themelore, Planimertia e ures, Preja A-A; Prerja B-B , Prerja C-C) ; Pershkrimi teknik i Projektit Ideor te Ures Automobilistike; Vizatimet teknike; CD-në; Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (811433309) të kompanisë hartuese të dokumentacionit investivo teknik); Dëshmi mbi pagesën, me rastin e aplikimit me nr. të fatures 000383, me vlerë prej 2,000.00 €. Licenca A e personit hartues të dokumentacionit inestivo teknik, Z Arsi RAPUCA , ashtu siq kërkohet me "Ush. Adm. MMPH, 03/2018 për Procedurat per Leje Ujqore". Andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, me kërkesën e parashtruar , është vendosur s në vendim për Pëlqim Ujqor.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 5255/25 - ZSP- 2025, datë: 10.07.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Mitrovica Veriore
- Arkivit të Ministrisë.

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

